



Tiranë, më 10.02.2022

Nr. 333. Prot.

Lenda: Problematika lidhur me procesin e Fiskalizimit.
Drejtuar: Z. Ceno Klosi,
Drejtor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
Znj. Delina Ibrahim, i
Minister, Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

Të nderuar,

Instituti i Kontabilistëve të Miratuar (IKM), nëpërmjet pjesëmarrjes në diskutimet e para të ligjit "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", komunikimit të vazhdueshëm me anëtarësinë për draftet dhe diskutimet duke marrë feedback-un e vazhdueshëm lidhur me to, dhe komunikimit të vazhdueshëm me DPT dhe MFE për të dhënë kontributin e vet në përmirësimin dhe suksesin e procesit të fiskalizimit, ka dërguar sugjerimet dhe komentet e saj për anëtarë pozitivë dhe problematikat e evidentuara gjatë vitit 2021 për përmirësimin dhe realizimin me sukses të procesit të fiskalizimit.

Nëpërmjet shkresës Nr. 376 Prot., date 28.12.2021 me lëndë "Shtyrja e gjobave dhe penalteteve që parashikon Ligji Nr. 87/2019, datë 18.12.2019, "Për Faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", për të gjitha kategoritë e biznesit" kemi evidentuar disa nga problematikat e procesit të fiskalizimit që kërkojnë zgjidhje. Nëpërmjet shkresës Nr. 23194/1 Prot., datë 12.01.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka kthyer përgjigje për disa prej problematikave të evidentuara. Ne ju falenderojmë për angazhimin dhe seriozitetin tuaj për kthimin e përgjigjeve në lidhje me problemet e evidentuara në këtë shkresë. Por ndërkaq vërejmë se disa prej përgjigjeve nuk janë të duhurat ose nuk janë shteruese. Më poshtë po listojmë disa prej problematikave për të cilat mendojmë se duhet një përgjigje më e plotë me qëllim edhe zgjidhjen e drejtë të tyre:

- 1. Libri i blerjeve dhe shitjeve në portalin SelfCare, nuk është i strukturuar dhe formatuar në përputhje me Ligjin e TVSH-së duke evidentuar kështu një konflikt me ligjin për TVSH-në.**

Në shkresën e dërguar, DPT shprehet se Format i librave të shitjes dhe blerjes është në përputhje me Ligjin Nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ne përputhje me Ligjin Nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 109, pika 3, formati i librave të shitjes dhe blerjes, përcaktohet në



formularin bashkëngjitur Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", në përputhje me pikën 1 të Nenit 68 të këtij udhëzimi dhe aktualisht është po i njëjti format që shkarkohet në sistemin e-Filling. Të dhënat dhe formati i Librave në SelfCare është i ndryshëm. Në formatet e pasqyruara në sistemin SelfCare ka më tepër të dhëna dhe kolona dhe rrjedhimisht ky format nuk përputhet me formatin e përcaktuar në Udhëzimin Nr. 6, datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave. Pra mendojmë se ky problem duhet zgjidhur ose duke ndryshuar formularin e këtyre librave në Self care ose duke bërë ndryshimin e formularit në Aneksin përkatës bashkëngjitur Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë".

2. Karta e Debitit dhe Kreditit konsiderohen mënyrë e ndryshme pagese nga ajo që parashikon ligji i TVSH-së.

Në shkresën e dërguar, DPT shprehet se në përputhje me Ligjin Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" i ndryshuar, në nenin 3 të tij, gërma (gj), ka parashikuar se: "Pagesë me para në dorë" konsiderohen edhe pagesat për mallrat ose shërbimet e furnizuara të kryera me kartë krediti ose debiti, të cilat konsiderohen mjete të ligjshme pagese, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe për qëllim të këtij ligji.

Sjellim në vëmendjen tuaj se në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 59, pika 1/1 përcaktohet se "Për qëllime të kësaj dispozite, nuk konsiderohet si transaksion i kryer me para në dorë pagesa për transaksionet, e cila kryehet nëpërmjet institucioneve financiare të parasë elektronike, të parasë elektronike, të licensuara nga Banka e Shqipërisë, ose pagesat e kryera me kartë krediti. Nga sa më sipër kemi dy përcaktime të ndryshme se çfarë do të konsiderohet pagesë me para në dorë, të cilat bien ndesh me njëra tjetrën. Mendojmë se ky problem i trajtuar ndryshe në këto dy ligje duhet të zgjidhet dhe se sipas opinionit tonë prioritet nga pikapamja e forcës ligjore ka Ligji Për procedurat tatimore.

3. Kursi i këmbimit i faturës së shitjes në rastin e eksporteve/importeve, sipas ligjit për TVSh-në, duhet të jetë ai i Bankes së Shqipërisë në ditën e lëshimit të faturës, kurse sipas ligjit të fiskalizimit kursi që duhet të përdoret në SelfCare është kursi i këmbimit që përdor dogana, që është i ndryshëm dhe sjell kështu diferenca.

Theksojmë se pyetja lidhet me mospërputhjen midis kursit të faturës për rastet e importeve/eksporteve. Në bazë të Ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" i ndryshuar, neni 6, pika 6 'për faturat në monedhe të ndryshme nga monedha kombëtare Lekë', vlera totale dhe vlera e pagueshme e TVSH-se do të duhet të shprehen në monedhën Lekë *sipas kursit të këmbimit të publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë në momentin kur është lëshuar fatura*. Kurse në procesin e fiskalizimit në SelfCare të faturave të improtit/eksportit në doganë kërkohet që kursi i faturës të jetë/vendoset sipas kursit të këmbimit që përdor dogana, pasi në të kundërt vlera e faturës nuk do të përputhet me vlerën e doganës në Lekë. Pra ka mospërputhje që pengon fiskalizimin e saktë të deklarave doganore.



4. Faturat e refuzuara në Selfcare shfaqen në libra dhe në pasqyrën mujore, por jo të transaksionet dhe anasjelltas.

Në shkresën e dërguar, DPT shprehet se faturat e refuzuara nga blerësi do të shfaqen të "Transaksionet e blerjes", për efekt evidence dhe historiku, por nuk do të shfaqen tek "Artikulli i librit të blerjes", që përbën bazën për deklarimin dhe pagesën e TVSH-së. Kjo problematikë lidhet me mospërputhjen në vlerë midis evidencave të ndryshme të ofruara nga sistemi SelfCare. Nëse faturat e refuzuara shfaqen në pasqyrën mujore por jo në transaksionet e blerjeve ose anasjelltas, kjo sjell mospërputhje midis evidencave të ndryshme. Gjithashtu, përdoruesit e sistemit eksportojnë librat e tyre nga sistemi SelfCare dhe listimi i faturave të refuzuara në këtë seksion e vështirëson deklarimin e librave sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, përgjigja e dhënë qëndron për sistemin aktual. Pas datës 30 Qershor 2022, kur librat do të ngarkohen automatikisht nga sistemi, përdoruesit nuk do të lejohen të shtojnë ose pakësojnë rreshta në to dhe për rrjedhojë kjo do të rezultojë në një deklaram të pasaktë.

5. Konstatohet një shqetësim i shtuar nga tatimpaguesit lidhur me sigurinë e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit të tyre, duke konsideruar që në SelfCare logohesh nëpërmjet llogarisë së tatimpaguesit në e-Albania.

Duke marrë në konsideratë natyrën sensitive të të dhënave, do të kërkonim një sqarim më të detajuar se si garantohet ruajtja e të dhënave të biznesit, pasi me zhvillimet e kohëve të fundit është çënuar integriteti dhe siguria e këtyre të dhënave. Përgjigja e dhënë në shkresën tuaj është shumë e përgjithshme dhe i referohet e-Albania, por nuk thuhet se si përcaktohet mbajtja e përgjegjësisë dhe nga kush në rast se këto informacione do të bëhen publike në rrugë joligjore.

6. Tatimpaguesit e vegjël dhe ata të zonave rurale nuk kanë infrastrukturën e duhur për të realizuar me sukses procesin e fiskalizimit.

Duke marrë në konsideratë mungesën e infrastrukturës në zonat rurale, ndoshta duhet të parashikohet një afat më i gjatë, mbase 2 (dy) vite për përgatitjen për të hyrë në fiskalizim.

7. Kompanitë softuerike nuk ofrojnë zgjidhje teknike për kërkesat ligjore të fiskalizimit.

Problematika e evidentuar në shkresën që kemi dërguar nuk e ka fokusin te përzgjedhja e kompanisë në bazë të kushteve dhe kriterëve specifike të njësisë ekonomike. Ne evidentojmë situatën që Kompanitë softuerike nuk ofrojnë zgjidhje për ato kushte dhe kriterë për të cilat janë licensuar. Kompanitë softuerike certifikohen dhe licensohen nga AKSHI dhe DPT, dhe për rrjedhojë duhet të jenë përgjegjëse edhe këto të fundit nëse kompanitë për ato procese që janë certifikuar nuk u përgjigjen tatimpaguesve, po ashtu dhe për dëmet që ato sjellin. Nuk mund të lihet tatimpaguesi në "dorën" e kompanive softuerike që kanë zgjedhur nga lista e publikuar për këto kompani nga DPT. Duhet që të përcaktohen edhe penalitetet dhe përgjegjësitë që ka kompania softuerike ndaj tatimpaguesit dhe organeve tatimore në raste të shkeljes së ligjit.



- 8. Vetëfaturimet (pra rasti i "faturave lëshuar nga blerësi") në disa software ndodh që të shfaqen edhe në librin e shitjes. Autongarkesat ka raste kur shfaqen në blerje me vlerë 0, ndërsa në shitje me vlerë, pra shfaqet vetëm si fature shitje.**

Ky fenomen nuk evidentohet vetëm në të dhënat e dërguara në administratën tatimore nëpërmjet zgjidhjeve softuerike, por edhe në ato raste kur vetëfaturimi kryhet nëpërmjet portalit SelfCare. Prandaj e mendojmë të udhës të shikohet zgjidhja e këtij problemi në Self care por edhe të mbahet përgjegjësi dhe të kërkohet nga kompanitë softuerike që janë licensuar nga Administrata Tatimore dhe AKSHI për këto procese.

- 9. Nuk është i mundur modifikimi i faturës së fiskalizuar nga operatorë të ndryshëm nga ai që e ka lëshuar faturën origjinale.**

Ky problem paraqitet kështu: nëse një faturë e lëshuar nga një operator X në një datë, psh 25 janar 2022, do të duhet të modifikohet në datën 4 shkurt 2022, atëherë nëse operatori X për një arsye apo për një tjetër, nuk është në punë atë ditë apo është larguar fare, kjo faturë nuk mund të modifikohet nga një operator tjetër. Kjo sepse sistemi Selfcare si duket e lidh faturën vetëm me një operator. Mendojmë që duhet të shikohet ky problem teknik në Selfcare sepse përndryshe kthehet në një problem të pazgjidhshëm për tatimpaguesit.

- 10. Nuk është përcaktuar në legjislacionin e fiskalizimit dhe nuk është parashikuar as në SelfCare procedura dhe mënyra se si duhet të deklarohen nga ana e tatimpaguesit pagesat e faturave jo nëpërmjet bankës.**

Problematika e evidentuar nuk e ka fokusin te përcaktimi i transaksioneve "me para ne dorë" dhe transaksioneve "pa para në dorë". Pyetja e ngritur lidhet me deklarimin e lëvizjes së pagesave të faturave me para në dorë, njëllon si bankat deklarojnë pagesën e faturave. Per ta konkretizuar, si do të deklarohet pagesa në arkë nëpërmjet portalit SelfCare ose zgjidhjes softuerike e një fature blerje me para ne dorë? Pra nuk është përcaktuar mënyra se si subjektet taimpaguese do të deklarojnë aarkëtimet apo pagesat e faturave nga arka dhe jo nga banka.

Gjithashtu në shkresën tuaj nuk është dhënë ende një përgjigje për problematikat e evidentuara në shkresën tonë si paraqiten më poshtë:

1. Platforma SelfCare lejon që faturës t'i jepet status edhe pas datës 10 të muajit paraardhës. Platforma lejon lëshimin, pranimin dhe refuzimin e faturave në cdo kohë. Referuar Nenit 8, të Ligjit Nr. 87/2019, date 18.12.2019 " Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" afati maksimal për t'i dhënë status faturës është data 10 e muajit paraardhës.
2. Nuk janë zgjidhur ende problematikat që lidhen me sektorin e karburanteve. Si do të lëshohet fatura tatimore per bizneset, që duan faturë tatimore për furnizimin që po bëjnë? Si do të veprohet në rastet kur përfaqësues të biznesit paraqiten në zyrë me kuponët për të marrë faturë fiskale (kuponi i kasës është deklaruar si shitje normale dhe është fiskalizuar si shitje normale, por fatura nuk i ka shkuar biznesit)? Si do të veprohet në rastet kur punëtori i pistoletës së karburantit lëshon një faturë tatimore gabim gjatë furnizimit? Edhe aktualisht pikat e shitjes së karburantit vijojnë të lëshojnë kuponin tatimor por nuk zgjidhet problemi që u përmend më sipër



Instituti i Kontabilisteve te Miratuar te Shqiperise
Albanian Institute of Certified Accountants

Për sa më sipër, ritheksojmë edhe njëherë domosdoshmërinë e shtyrjes së afatit të vendosjes së penaliteteve për të gjithë tatimpaguesit që zbatojnë lëshimin e faturave të fiskalizuara, pasi rrezikojnë të penalizohen me gjoba padrejtësisht për probleme dhe gabime që nuk janë pasojë e veprimeve të tyre, por e problemeve ligjore apo të platformës së fiskalizimit, ashtu si parashtruam edhe më lart në këtë shkresë.

Duke shpresuar që kërkesa jonë të merret në konsideratë në të mirë të këtij procesi të rëndësishëm.

Me respekte dhe vlerësime,

Kryetari i Këshillit të Drejtimit të IKM

Prof. Dr. Sotiraq Dhano

